



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:214856

Datë: 15.06.2023

Numri i dokumentit: 04396392

**PS.nr.38/2022**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI SPECIAL NË PRISHTINË**, Kryetari i Trupit Gjykses, Gjyqtari Valon Kurtaj, me Anëtarët e Trupit Gjykses, Gjyqtaren Valbona Musliu Selimaj e Gjyqtarin Musa Konxheli dhe pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores Profesionale Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. N., i akuzuar për veprën penale krim i organizuar nga neni 283 paragrafi 1 lidhur me nenin 273 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 281 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.9 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës PPS.nr.54/2019 të datës 27.09.2019 të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, pas mbajtjes së një sërë shqyrtimesh gjyqësore publike në prezencë të Prokurores të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Prokurore Ilirjana Çollaku Tafaj, të akuzuarit A. N. e mbrojtësit të tij Avokat N. R., me datë **14.04.2023**, publikisht mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### Ndaj të akuzuarit:

A. N., i lindur me datë ..., nga i ati S., e ëma A. e vajzërisë I., me vendbanim në T. të Republikës së Shqipërisë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, posedon kartë identiteti me numër personal ... dhe pasaportë të Republikës së Shqipërisë me numër ..., shtetas i Republikës së Shqipërisë.

## ËSHTË FAJTOR

Se gjatë periudhës kohore nga viti 2018 e deri më 09.02.2019, i akuzuari A. N. në vazhdimësi e së bashku me tani të dënuarit sipas aktgjykimit të formës së prerë (PS.nr.39/2019 të datës 26.02.2021) B. S., Xh. S., G. K., J. B., F. B., F. B., D. S., H. B. e të dyshuarin në arrati Z. K., duke vepruar si pjesë e grupit me të dënuarit e potencuar e me qëllim që pa autorizim të shpërndajnë, shesin, transportojnë, ndërmjetësojnë në shitje, e duke dërguar në transit substancë narkotike të shpallura me ligj si substancë e ndaluara, respektivisht substancë narkotike të llojit "Marihuanë" në sasi të konsiderueshme (të madhe), e ku:

I akuzuari **A. N.**, brenda kësaj periudhe kohore të kryerjes së veprës penale sjell katër herë ngarkesa të narkotikut të llojit "Marihuanë", ndër këto katër herë të sjelljes së narkotikut të llojit "Marihuanë", ka sjellë edhe me datë 17.01.2019 e me datë 08.02.2019, me automjetet: kamionetë ngjyrë të bardhë me targa të Shqipërisë dhe kamionetë ngjyrë portokalli;

I akuzuari **A. N.**, gjatë periudhës kohore 2018 e deri më 09.02.2019 (për të cilën akuzohet), i ka sjellë katër herë sasi të konsiderueshme të narkotikut të llojit "Marihuanë" tani të dënuarit **B. S.**, ku këtë narkotik tani i dënuari **B.S.** (duke kërkuar edhe ndihmën e birit të tij të mitur), së pari e ka sistemuar (fshehur) në një shtëpi të braktisur përballë shtëpisë së tij në fshatin ... të Komunës së **F.**, e pastaj këtë narkotik ua ka dhënë tani të dënuarve **Xh.S.**, **J.B.** dhe të dyshuarit në arrati **Z.K.** me qëllim të transportimit dhe shitjes për në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku me datë 08.02.2019, kanë marrë narkotikun me qëllim të transportimit e shitjes në Republikën e Maqedonisë Veriore, mirëpo meqenëse kanë hasur në patrulla policore gjatë rrugës në transportim, të njëjtin-këtë narkotik në pamundësi të dërgimit për në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me datë 09.02.2019, ia kthejnë përsëri **B.S.**, ku takohen me tani të dënuarin **B.S.** e tani të dënuarin **G. K.**, në fshatin ... të Komunës së **F.** në vendin afër xhamisë së fshatit, tani të dënuarit **B.S.** e **G. K.**, ua marrin makinën "WV ..." të ngarkuar me narkotik, shkojnë në fshatin ... të Komunës së **F.**, në mobilierinë "N." pronë e tani të dënuarit **G.K.**, e sistemojnë këtë sasi narkotiku në këtë mobilieri, respektivisht në krevate të fjetjes (dhomave të fjetjes), e ku gjatë kontrollit të kësaj mobilierie narkotiku prej 223 paketime në sasi prej 209.202 kg, është sekuestruar nga policia me datë 09.02.2019, kurse me datë 11.02.2019, po në të njëjtën mobilieri janë gjetur e sekuestruar edhe 30 paketime në sasi prej 32.131 kg, pra sasi e përgjithshme prej 241.33 kg;

I akuzuari **A.N.** këtë sasia të konsiderueshme të narkotikut të llojit "Marihuanë" e sjellë nga Republika Shqipërisë, katër herë gjatë periudhës kohore 2018 e deri më 09.02.2019, ku fillimisht dërgohet deri tek i dënuari **B.S.** në fshatin ... të Komunës së **F.**, **B.S.** e sistemon në fshatin e tij e më pas ua jep tani të dënuarve **Xh.S.**, **J.B.** e të dyshuarit në arrati **Z.K.**, që këtë substancë narkotike ta transportojnë me qëllim shitje në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa të dënuarit e tjerë **F. B.**, **F. B.**, **D.S.** e **H.B.**, duke u bërë transportimi i substancës narkotike, kanë siguruar rrugën gjatë transportit, siguruar që të mos vihen re nga policia (për të mos u vërejtur nga policia) dhe atë me automjetet "..." pa targa të regjistrimit, "..." me targa ..., "WV ..." me targa ..., "WV ..." me targa ..., "WV ..." me targa ..., "WV ..." me targa ... dhe "WV ..." me targa ..., ku:

Me datë 03.10.2018, me automjetin "..." pa targa, transportojnë narkotik në sasi prej 108 kg me qëllim shitje deri afër kufirit shtetëror Republika e Kosovës-Republika e Maqedonisë së Veriut, duke kaluar ilegalisht kufirin jashtë vendkalimit kufitarë dhe pasi u vënë re nga Policia Kufitare e Republikës së Kosovës, hodhën nga automjeti në tokë narkotikun te vendi i quajtur "..." e pastaj hynë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa Policia Kufitare e Republikës së Kosovës, merr narkotikun e llojit "Marihuanë" në sasi prej 108 kg dhe e sjell në Stacionin Policor në H.të E.;

Me datë 08.02.2019, pasi që ishte sjellë më herët sasia e narkotikut "Marihuanë" (për katër herë sikurse theksuar më lartë në këtë dispozitiv) nga Republika e Shqipërisë nga i akuzuari **A.N.** dhe ishte vendosur tek tani i dënuari **B.S.** në fshatin ... të Komunës së **F.**, ku tani të dënuarit e tjerë **Xh.S.**, **J.B.** dhe i dyshuari në arrati **Z.K.**, kanë marrë narkotikun nga tani i dënuari **B.S.**, me qëllim të transportimit dhe shitjes në Republikën e Maqedonisë Veriore, ndërsa tani të dënuarit e tjerë **F.B.**, **F.B.**, **D.S.** e **H.B.**, ( me veturat: "..." me targa ..., "WV ..." me targa ..., "WV ..." me targa ..., "WV ..." me targa ..., "WV ..." me targa ... dhe "WV..." me targa ...

kanë transportuar, vrojtuar e përcjellë rrugën për në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mirëpo meqenëse kanë hasur në patrulla policore gjatë rrugës në transportim, këtë narkotik në pamundësi të dërgimit për në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me datë 09.02.2019 ia kthejnë të dënuarit B.S., ku tani i dënuari J.B. me të dyshuarin në arrati Z.K., fillimisht e marrin automjetin "WV ..." me targa ... nga restauruan "... " ku e kishin lënë një ditë përpara, pastaj përmes rrugë magjistrale nga restauruan "... " shkojnë deri në fshatin ... të F., ku takohen me të dënuarin B.S. dhe të dënuarin G.K., në vendin afër xhamisë së fshatit, B.S. dhe G.K., ua marrin makinën "WV ..." të ngarkuar me narkotik, shkojnë në fshatin ... të Komunës së F., në mobilierinë "N." pronë e të dënuarit G.K., e sistemojnë këtë sasi narkotiku në këtë mobilieri, e ku gjatë kontrollit të kësaj mobilierie narkotiku prej 223 paketime në sasi prej 209.202 kg është sekuestruar nga policia me datë 09.02.2019, kurse me datë 11.02.2019, po në të njëjtën mobilieri janë gjetur e sekuestruar edhe 30 paketime në sasi prej 32.131 kg, pra sasi e përgjithshme prej 241.33 kg.

**Me këto veprime i akuzuari A.N. (me tani të dënuarit e kësaj çështje) ka kryer veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK, lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 të KPRK dhe nenin 81 të KPRK.**

Gjykata në kuptim të dispozitave të neneve: 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 20, 21, 42, 43, 73, 81, 273 paragrafi 2, neni 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 të KPRK, të akzuarit i shqipton:

## **DËNIMIN ME BURGIM DHE DËNIMIN ME GJOBË**

Duke ia vërtetuar/shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **5** (pesë) **vite** burgim.

Duke ia vërtetuar/shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **2.500** (dy mijë e pesëqind) **Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj të akzuarit me dënim me burgim, duke llogaritur **20** (njëzet) **Euro** për një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shumën prej **200** (dyqind) **Euro**, në emër të shpenzimeve procedurale dhe shumën prej **100** (njëqind) **Euro** në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Sasia e narkotikut objekt i kësaj çështje penale, është e konfiskuar me Aktgjykimin PS.nr.39/2019 të datës 26.02.2021.

## **A r s y e t i m**

## **Historiku procedural i çështjes:**

Me datë 29.09.2019, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur Aktin akuzues PPS.nr.54/2019, kundër të akuzuarit Xh.S. i akuzuar për veprën penale krim i organizuar nga neni 283 paragrafi 2 e lidhur me nenin 273 paragrafi 2 dhe nenin 281 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.9 i KPRK dhe kundër të akuzuarve: B.S., A.N., G.K., J.B., F.B, F.B., D.S. dhe H.B., të akuzuar për veprën penale krim i organizuar nga neni 283 paragrafi 1 e lidhur me nenin 273 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të KPRK, po ashtu B.S. i akuzuar edhe për veprën penale të shmangies nga tatimi nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK.

Pas marrjes së formës së prerë të aktit akuzues, gjykata ka caktuar dhe mbajtur një sërë shqyrtimesh gjyqësore në këtë çështje penale, ku me datë 26.02.2021, publikisht ka shpallur Aktgjykimin PPS.nr.39/2019. Me këtë aktgjykim, gjykata ka shpallur të akuzuarit e lartë-përmendur fajtor dhe iu ka shqiptuar dënim me burgim, respektivisht i ka shpallur fajtor për veprën penale të ri-cilësuar nga gjykata, veprën penale në vazhdimësi blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK, lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 të KPRK dhe nenin 81 të KPRK.

Gjykata, po ashtu të akuzuarin B.S. e ka shpallur fajtor edhe për veprën penale në vazhdimësi shmangia nga tatimi nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK, lidhur me nenin 81 të KPRK.

Ndaj aktgjykimit të lartë-theksuar, Prokuroria Speciale, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre kanë parashtruar ankesë.

Në raport me ankesat e parashtruara nga palët, Gjykata Apelit-Departamenti Special në Prishtinë, ka marrë aktgjykimin<sup>1</sup> me të cilin aktgjykim e ka vërtetuar-lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë për të gjithë të akuzuarit tjerë, përpos për të akuzuarin A.N., për të cilin e ka anuluar vendimin e shkallës së parë dhe kthyer në ri-gjykim<sup>2</sup>.

Me datë 14.01.2022, Gjykata Themelore-Departamenti Special në Prishtinë, sipas rekomandimeve të Gjykatës Apelit-Departamenti Special në Prishtinë dhe pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, ka shpallur Aktgjykimin PS.nr.48/021, ku ndaj të akuzuarit ka nxjerr aktgjykim refuzues. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi, ndërsa Gjykata e Apelit-Departamenti Special me datë 15.09.2022, duke vendosur sipas ankesës e ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen e ka kthyer përsëri në rigjykim<sup>3</sup>.

Gjykata Themelore-Departamenti Special në Prishtinë, në ri-gjykim ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në bazë të rekomandimeve të Gjykatës së Apelit dhe me datë 14.04.2023, ka bërë shpalljen e këtij aktgjykimi (shqyrtime gjyqësore në të cilat me dakordimin e palëve janë administruar të gjitha provat e proceduara nga gjykata në shqyrtimet e mëparshme).

## **Fjala përfundimtare e palëve:**

<sup>1</sup> Aktgjykim i Gjykatës së Apelit-Departamenti Special, nën numrin APS.nr.23/2021 i datës 21.09.2021.

<sup>2</sup> Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, nën numrin PS.nr.39/2019 i datës 26.02.2021.

<sup>3</sup> Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit-Departamenti Special, nën numrin APS.nr.13/2022 i datës 15.09.2022.

Prokurori nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në fjalën përfundimtare ka theksuar se:

- Pasi që kjo çështje është kthyer në ri-gjykim me Vendim të Gjykatës së Apelit APSnr.13/22 të datës 15.09.2022, vetëm për të akuzuarin A.N., në fillim të këtij shqyrtimi gjyqësor Prokuroria e kishte njoftuar Gjykatën se bazuar në dispozitën ligjore të nenit 406 të KPPRK, atëherë në fuqi, ku përcakton se në procedurën e rigjyimit në gjykatë themelore sipas vendimit të Gjykatës së Apelit “*Gjykata themelore të cilës i është dërguar lënda për gjykim procedon në bazë të aktakuzës së mëparshme*”, Prokuroria në këtë fazë të procedurës ka mbetur në tërësi pranë Aktakuzës së datës 27.09.2019 në raport me të akuzuarin A.N.;
- Lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet i akuzuari A.N., prokuroria e njofton gjykatën se bazuar në nenin 397 dhe nenin 351 të KPPRK, ri-cilëson veprën penale ndaj këtij të akuzuari dhe atë nga vepra penale për të cilën është ngritur aktakuza ndaj tij dhe të bashkakuarve të tjerë, e që ishte krimi i organizuar i sanksionuar me nenin 283 paragrafi 1 lidhur me nenin 281 nën paragrafi 1.9 e lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja apo shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope, sanksionuar me nenin 273 paragrafi 2 të KPK, në veprën penale të kryer “në vazhdimësi blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK, lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 të KPRK dhe nenin 81 të KPRK;
- Këtë ri-cilësim prokuroria e bën duke pasur parasysh faktin se ndaj të bashkë-akuzuarve të A.N., tashmë ekziston një aktgjykim i plotfuqishëm në bazë të të cilit është ri-cilësuar vepra penale për të cilën ishte ngritur aktakuza, ri-cilësim ky i cili shkon në dobi edhe të të akuzuarit A.N., bazuar në parimin “*Beneficium cohaesionis*” të paraparë në dispozitat ligjore të KPPRK, si dhe bazuar në faktet e çështjes të vërtetuara nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në mbështetje të nenit 351 të KPPRK;
- Prandaj, prokuroria konsideron se me provat materiale e personale që janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor e të cilat prokuroria edhe i ka elaboruar në këtë fjalë përfundimtare, pa mëdyshje është vërtetuar se i akuzuari A.N., së bashku edhe me të akuzuarit tjerë të cekur në aktakuzë ka kryer veprën penale të ri-cilësuar në vazhdimësi blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK, lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 të KPRK dhe nenin 81 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën si të përshkruar në dispozitivin I. të aktakuzës;
- Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, prokuroria konsideron se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, situata faktike se i akuzuari A.N., gjatë periudhës kohore nga viti 2018 e deri më 09.02.2019, në vazhdimësi së bashku edhe me të akuzuarit tjerë tashmë të dënuar dhe me të dyshuarin që ndodhet në arrati Z.K., duke vepruar si grup e me qëllim që pa autorizim të shpërndajnë, shesin, transportojnë, ndërmjetësojnë në shitje, e duke dërguar në transit substanca narkotike të shpallur me ligj si substanca të ndaluara, respektivisht substancë narkotike të llojit “*Marihuanë*” në sasi të konsiderueshme. Ku i akuzuari A.N.,

brenda kësaj periudhe kohore të kryerjes së veprës penale sjellë së paku katër herë ngarkesa të narkotikut të llojit “Marihuanë” deri tek (tashmë i dënuari) B.S., respektivisht në fshatin ... të komunës së F., ku A.N. ndër këto katër herë të sjelljes së narkotikut të llojit “Marihuanë” ka sjellë edhe me datë 17.01.2019 e me datë 08.02.2019, ku këtë narkotikë e ka sjellë nga Republika e Shqipërisë për në fshatin ... të komunës së F., deri tek (tashmë i dënuari) B.S., me automjetet: kamionetë ngjyrë të bardhë me targa të Shqipërisë dhe kamionetë ngjyrë portokalli. Narkotiku i sjellë nga i akuzuari A.N. i llojit “Marihuanë” më pas të akuzuarit tjerë të cilët tashmë janë dënuar së bashku edhe me të pandehurin që ndodhet ende në arrati Z.K. e fshehin e tentojnë ta transportojnë për në Maqedoninë e Veriut, në mënyrën si të përshkruar në Aktakuzë ku janë përshkruar veprimet e secilit nga të akuzuarit tjerë, sasi kjo e gjetur nga Policia e Kosovës, gjatë kontrollit në mobilierinë “N.” në fshatin ... të komunës së F., pronë e të bashkakuzuarit tashmë të dënuar G.K., ku me datë 09.02.2019, janë gjetur dhe sekuestruar 223 paketime në sasi prej 209.202 kg narkotikë e llojit “Marihuanë”, ndërsa me datë 11.02.2019 në të njëjtën mobilieri nga Policia e Kosovës, gjatë kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar 30 paketime të tjera në sasi prej 32.131 kg, pra në sasi të përgjithshme prej 241.33 kg;

- Prokuroria konsideron se gjykata për të vërtetuar këtë gjendje faktike, duhet të marrë parasysh po ashtu faktin se i akuzuari B.S., ishte shpallur fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet të ri-cilësuar nga gjykata dhe se rrethanat e rastit kishin të bënin po ashtu me faktin se B.S., gjatë periudhës kohore të lartcekur për të cilën akuzohet edhe i akuzuari A.N., ka pranuar katër herë sasi të narkotikut të llojit marihuanë nga një person për të cilin B.S., gjatë hetimeve dhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se e kishte pranuar nga “një person i Shqipërisë i quajtur Ç.”, duke ju shmangur referimit të të akuzuarit A.N.. Në anën tjetër, faktet e vërtetuara tregojnë se B.S., kishte përdorur numrin e telefonit ..., numër me të cilin kishte komunikuar me numrin ..., për organizimin e pranimin e dorëzimit të narkotikut nga personi “Ç.” nga Shqipëria, për në shtëpinë e B.S. Se numri i telefonit me të cilin kishte komunikuar B.S., 049... i takonte A.N., vërtetohet edhe me faktin se në procesin gjyqësor në të cilin i akuzuari A.N., kishte pranuar fajësinë për gjendjen faktike për të cilën ishte shpallur fajtor (lënda me numër të gjykatës PS.nr.42/2020), ndër provat e parashtruara ishin edhe përgjimet e telekomunikimeve të numrit 049... i cili numër i dedikohej A.N., fakt të cilin i njëjti nuk e kishte kundërshtuar;
- Nga të gjitha faktet e lartcekura dhe ndërlidhur me deklaratën e dëshmitarit A.S., vërtetohet se personi i quajtur “Ç.” i cili e kishte sjellë narkotikun tek B.S., ishte pikërisht i akuzuari A.N.. Sa i përket deklaramit të të akuzuarit A. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtje të tij në bazë të të cilës i akuzuari mohon fajësinë, prokuroria konsideron se i njëjti kishte deklaruar në këtë mënyrë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe se e njëjta nuk përkon me asnjë nga provat materiale dhe personale të administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor. Prokuroria sërish konstaton se të gjitha provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ishin marrë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore relevante të KPPRK dhe si të tilla duhet të konsiderohen të ligjshme e të pranueshme.

- Po ashtu gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, mbrojtja pretendon se ndaj të akuzuarit A.N., lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet në bazë të kësaj aktakuzë “nuk kishte aktvendim për fillimin e hetimeve”. Mbrojtja edhe gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ka shprehur këtë pretendim edhe pse tashmë ekziston një Aktvendim i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në bazë të të cilës ishte mohuar një pretendim i tillë i mbrojtjes, duke cekur se “Kolegji i Gjykatës së Apelit e vlerëson si të pabazuar pretendimin e mbrojtjes kur thekson se Gjykata e Apelit e ka kthyer në rigjykim këtë çështje në mungesë të ekzistimi të aktvendimit të hetimeve, ky pretendim është i pabazuar, nga se Gjykata e Apelit, ku këtë çështje penale e ka kthyer në rigjykim për shkak të shkeljeve esenciale lidhur me mungesën e arsyeve në aktgjykim për pretendimin e mbrojtjes nëse hetimi ndaj të akuzuarit A.N., ka qenë edhe për veprën penale të pjesëmarrjes apo organizimin të grupit kriminal, çka rezulton se Gjykata e Apelit, anulimin e aktgjykimit paraprak e ka bërë për shkak të mungesës së arsyeve ndaj pretendimit të mbrojtjes, por nuk ka konstatuar asnjëherë se nuk janë zhvilluar hetimet ndaj këtij të akuzuari për këtë vepër penale”;
- Lidhur me këtë pretendim të mbrojtjes, prokuroria sërish mbron qëndrimin se një konstatim të tillë mbrojtja e ka bazuar në fakte të pasakta, meqenëse i akuzuari A.N., ishte hetuar, ndaj tij kishte pasur Aktvendim për zgjerimin e hetimeve për veprën penale për të cilën akuzohet sipas rastit me numër PPS.nr.54/19 dhe pikërisht për veprën penale për të cilën akuzohet e që ishte vepra penale krim i organizuar nga neni 283 paragrafi 1 lidhur me nenin 281 nën paragrafi 1.9 lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope e anologe nga neni 273 paragrafi 2 dhe 1 të KPRK, procedurë kjo e udhëhequr në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të KPPRK, për fillimin e procedurës penale me fazën e hetimit formal;
- Pretendimet e mbrojtjes lidhur me këtë fakt, i njëjti i bazon në kërkesën e PSRK drejtuar gjykatës për veçimin e procedurës penale dhe aktvendimin e gjykatës për veçimin e procedurës penale bazuar në kërkesën e prokurorisë të cilat i njëjti i kishte paraqitur edhe si prova gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor. Prokuroria konsideron se përveç me kërkesën e prokurorisë për veçimin e lëndës drejtuar gjykatës, një ndarje të tillë po ashtu e kishte cekur edhe në të dyja aktakuzat e ngritura ndaj të akuzuarit A.N. dhe të bashkakuarve të tjerë, nën numrat PPS.nr.11/19 e PPS.nr.54/19, ku kishte sqaruar si në vijim: “kjo kërkesë për veçim të lëndës është bërë me qëllim të zhvillimit dhe mbarëvajtjes më të mirë të procedurës penale sepse në rastin konkret kryerja e veprave penale dhe arrestimi i të pandehurave nuk përputhet në të njëjtën kohë dhe as provat nuk na ndërlihen”. Në këtë situatë vetëm për të pandehurin A.N., zhvillohen procedura në të dy rastet (shih faqe 8 të Aktakuzës PPS.nr.54/19 të datës 27.09.2019 dhe faqe 4 të Aktakuzës PPS.nr.11/19 të datës 15.11.2019). Rrjedhimisht, prokuroria konsideron se në rastin konkret nuk ka bazë ligjore për të konstatuar se ndaj të pandehurit A.N. në rastin PPS.nr.54/19, nuk kishte të iniciuar procedurë formale të hetimit apo aktvendim për zgjerimin e hetimeve. Kjo, sepse prokuroria nuk ka pasur bazë ligjore që për të njëjtin person të zgjerojë hetimet për të njëjtën vepër për të cilin tashmë kishte aktvendim për zgjerimin e hetimeve. Por, pas zbatimit të hetimeve për rastin në fjalë për të cilin ishin iniciuar dhe zgjeruar hetimet pas identifikimit të secilit prej të akuzuarve me qëllim

të efikasitetit të procedurës, ashtu si edhe është cekur në arsyetim të aktakuzës, procedura ishte veçuar në dy lëndë të ndara;

- Nisur nga të gjitha sa u thanë, prokuroria i propozon gjykatës që i akuzuari A.N., të shpallët fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet të ri-cilësuar siç u cek më lartë dhe i njëjti të dënohet sipas ligjit duke marrë parasysh rrethanat rënduese të parapara me dispozitat ligjore të KPRK. Neni 73 i KPRK, përcakton se me rastin e dënimit, gjykata merr parasysh dhe vlerëson të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prokuroria konsideron se në rastin konkret ndaj të akuzuarit A.N., aplikohen këto rrethana rënduese:

- 1) Shkalla e lartë e përgjegjësisë penale-përfshirja e të akuzuarit A.N. në grupin kriminal i cili është marrë me shitblerjen e shpërndarjen e narkotikëve si në dispozitivët e aktakuzës të vërtetuar gjatë shqyrtimi gjyqësor, ishte e lartë ku i njëjti kishte rolin e personit që sillte narkotikë nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës, me qëllim transportin e mëtejme të të njëjtës sasi;
- 2) Motivi për kryerjen e veprës penale-i njëjti i ndikuar nga motivi financiar kryente veprime kriminale në dëm të interesave të përgjithshme të shoqërisë, shëndetit dhe sigurisë së qytetarëve;
- 3) Kryerja e veprës penale të shitblerjes së narkotikëve si grup dhe në vazhdimësi-një rrethanë e tillë merret si rënduese dhe me përcaktimin ligjor të veprës penale;
- 4) Sasia e madhe e narkotikut-nga faktet e vërtetuara lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet i akuzuari A.N., është vërtetuar se sasia e sekuestruar nga policia e për të cilën ishte vërtetuar se ishte sjellë nga i akuzuari A.N., tek të bashkakuazarit e tjerë ishte rreth 241.33 kg;
- 5) Rrezikshmëria-trendi i rritjes së veprave penale të narkotikëve tregon shkallën e rrezikshmërisë së lartë të kësaj vepre penale. Nisur nga sa u tha më lartë, prokurori i shtetit konsideron se në rastin konkret nuk ka rrethana lehtësuese që do të aplikoheshin me rastin e matjes së dënimit për të akuzuarin.

I akuzuari **A.N.**, respektivisht mbrojtësi i tij Avokat N. R., në fjalën përfundimtare ka theksuar se:

- A.N., nuk është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, ku gjykata në mungesë të provave duhet ta liroj këtë të akuzuar;
- Prokuroria fillimisht ka filluar hetimin për vepër penale tjetër për të akuzuarin A.N. dhe atë me të bashkakuazarit V. E., L. O., I. B. e M. E. Më pas ka filluar me zgjerimin e hetimeve, ku padrejtësisht e ka përfshirë edhe të akuzuarin A.N. me të akuzuarit e kësaj çështje penale e cila është objekt shqyrtimi dhe atë për veprën penale të krimit të organizuar, pa pasur aktvendim për fillim të hetimit asnjëherë, më pastaj as aktvendim për zgjerim të hetimit, pra



A.N. është subjekt edhe i Aktit Akuzues PPS.nr.11/2019 dhe i Aktit Akuzues PPS.nr.54/2019, ku të dy këto akte trajtohen nga i njëjti departament dhe e njëjta gjykatë;

- Dispozitat e nenit 6 të KPPRK, përcaktojnë fillimin e hetimit, ku në rastin konkret ndaj A.N., nuk ka pasur as aktvendim për fillimin e hetimit e as më vonë aktvendim për zgjerimin e hetimeve për veprën penale të krimit të organizuar;
- Prokuroria Speciale, ka dorëzuar përmes gjykatës Aktvendimin PPS.nr.11/2019 me të cilin është bërë zgjerimi i hetimeve, mirëpo ky zgjerim i hetimeve nuk ka të bëjë me të akuzuarin A.N. në raport me të akuzuarit Xh.S. etj., por ka të bëjë me të akuzuarit V. E. etj.;
- Në raport me aktakuzën PPS.nr.54/2019, ndaj A.N. nuk ka aktvendim për fillimin e hetimeve e as aktvendim për zgjerimin e hetimeve, që i bie se kemi një aktakuzë pa hetim. Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka filluar hetimin e pastaj edhe zgjeruar hetimin për të akuzuarit Xh.S. etj., mirëpo as në aktvendimin për fillim të hetimeve e as në aktvendimin për zgjerimin e hetimeve në këtë çështje penale nuk e ka përfshirë asnjëherë të akuzuarin A.N.;
- Përgjimi i telekomunikimeve i numrit 049..., është bërë pa aktvendim për fillim të hetimeve dhe atë fillimisht ndaj S. N., mirëpo nuk ka pasur asnjëherë aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj A.N. apo S. N.;
- A.N. është akuzuar mbi të njëjtat shkresa materiale të të dy akuzave, nuk ka asnjë material dhe biseda telefonike e cila e ndërlidh A.N. me të akuzuarit e tjerë, respektivisht Xh.S. etj.;
- A.N. për veprën penale tjetër për të cilën akuzohet sipas një aktakuze tjetër, vetëm se e ka pranuar fajësinë dhe e ka përfunduar atë çështje, ndërsa nuk ka të bëjë fare me këtë çështje penale për të cilën po gjykohet;
- Gjykata Themelore-Departamenti Special në Prishtinë, ka veçuar çështjen penale me aktvendim për veçim, e ku padrejtësisht pas veçimit të çështjes hetimore A.N. e ka futur në të dy aktakuzat dhe atë vetëm tre ditë pasi që është ngritur aktakuza, është veçuar procedura, por prokuroria nuk ka dhënë asnjë sqarim sa i përket kësaj çështjeje;
- Aktakuza është ngritur mbi bazën e deklaratës së një dëshmitari, dëshmitarit A.S., i cili nuk ka mundur të jetë fare dëshmitar se ai është dëshmitar i liruar nga përgjegjësia për të deklaruar, pasi që është në raport familjar me të akuzuarin B.S., ku të njëjtin e ka baba dhe po ashtu është i moshës së mitur;
- Akti akuzues potencon se dëshmitari A.S., i ka ndihmuar disa here babait të tij B.S., në bartjen e sistemimin e narkotikut dhe se i ka pranuar për këtë 100 Euro, bazuar në këtë, ky dëshmitar nuk duhet të ishte dëshmitar por duhet të ishte i akuzuar, përpos që është dëshmitar i privilegjuar;
- Sa i përket dëshmitarit A.S., ndaj të njëjti është ushtruar dhunë dhe është detyruar të pranoj ato çfarë ia ka imponuar policia, andaj deklarata e tij nuk mundë të shërbej si provë. Si me

rastin e kontrollit të shtëpisë ku ka qenë i sistemuar narkotiku e po ashtu edhe në deklaratimet në hetuesi, ndaj të njëjtit është përdorur forcë e presion, pasi që është kërkuar të pranoj ato të cilat janë konstatuar nga hetuesit. Po ashtu me rastin e marrjes së deklaratës së dëshmitarit, respektivisht me rastin e ofrimit të fotografive për identifikim të të akuzuarve në këtë çështje penale, sidomos për të akuzuarin A.N., identifikimi është bërë jo në harmoni me dispozitat ligjore dhe nën ushtrimin e ndikimit nga hetuesit;

- Sa i përket deklaratave të dëshmitarëve, hetuesve V. G. e I. B. të pyetur në cilësi të dëshmitarëve, gjykata nuk është dashur t'i dëgjoj këta dëshmitarë, pasi që sipas dispozitave ligjore këta nuk kanë mundur të dëgjohen në cilësi të dëshmitarëve pasi që dëshmitarët deklarojnë atë që e kanë dëgjuar apo parë, ndërsa në rastin konkret këta dëshmitarë kanë pasur të deklarojnë për dhunën e ndikimit të ushtruar ndaj dëshmitarit A.S. nga hetuesit. Mbrojtja ka vërejtje në deklaratat e këtyre dëshmitarëve pasi që të njëjtët nuk kanë dhënë deklaratat të besueshme, nuk kanë qenë në gjendje fare të tregojnë procedurën e identifikimit e të marrjes së deklaratës se si është bërë, por vetëm duke deklaruar se çdo gjë është e konstatuar në procesverbal të marrjes së deklaratës dhe identifikimit të personit;
- Dëshmitari N. V., zyrtar social, i njëjti ka deklaruar se nuk është e vërtetë se të ketë fjetur gjatë intervistimit të dëshmitarit A.S., mirëpo kjo deklaratë mbrojtja pretendon se është provë e papranueshme sepse kemi të bëjmë me dëshmitar të privilegjuar dhe se me rastin e marrjes së deklaratës së këtij dëshmitari, nuk është njoftuar asnjë nga prindërit e dëshmitarit të mitur, përpos faktit që babai i tij është i akuzuar në këtë çështje penale, ka mundur të angazhohet nëna e tij apo të paktën xhaxhai i tij të jetë prezent gjatë marrjes së deklaratës;
- Dëshmitari B. S., xhaxhai i dëshmitarit A.S., i cili dëshmon se ndaj A. të jetë përdorur dhunë e presion gjatë kontrollit të shtëpisë së braktisur në të cilën ka qenë i sistemuar narkotiku, por edhe gjatë marrjes së deklaratave nga hetuesia ku është njoftuar nga A.S. se kanë ushtruar presion dhe se punëtori social gjatë gjithë kohës së deklarimit ka fjetur. Në kuptim të nenit 128 të KPPRK, deklaratat e dëshmitarit A.S., duke përfshirë edhe atë të identifikimit nuk mundë të procedohen si prova të pranueshme pasi që është marrë në kundërshtim me këtë dispozitë;
- BMS e hyrje-daljeve të kufirit, nuk mundë të merren si prova, pasi që nuk vërtetojnë asgjë në raport me akuzën, sepse A.N., është nga T. dhe se ai qarkullon pothuajse çdo ditë për në Kosovës, pasi që tërë jetën e zhvillojnë në Kosovë;
- Duke qenë të bindur se e gjithë procedura e zhvilluar deri më tani është një epilog i pasaktë dhe pa asnjë qartësi lidhur me veprimet apo mosveprimet e A.N.t në këtë rast, pra shihet qartë se vetë policia dhe prokuroria e kanë ditur se A.N., nuk ka lidhje me këtë grup dhe për këtë arsye kanë kërkuar zyrtarisht që ai të ndahet nga këta persona me të cilët prapë është akuzuar, e që ajo rezulton vetëm tendencioze të jetë e assesi ndonjë veprim mbi bazën e provave;

- Duke u bazuar në të lartcekurat dhe në gjithë procedurën e zhvilluar pranë kësaj gjykate, shkresave të lëndës, ka kërkuar nga gjykata që ta lirojë A.N. nga kjo aktakuzë e cila para së gjithash nuk u provua se ai ishte implikuar fare në këtë veprë penale dhe se përfundimisht janë dy mundësi e që ne vlerësojmë vetëm se mbetet te forma e aktgjykimit;
- Ndaj A.N. të merret aktgjykim refuzues nga neni 363 paragrafi 1.2 të KPPRK, duke vlerësuar se i akuzuari për të njëjtën veprë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë ose procedura kundër tij është pushuar me aktvendim të formës së prerë e që në rastin konkret disa shkresa që janë në këtë lëndë, janë trajtuar në lëndën që është gjykuar, apo të nxirret aktgjykimi lirues neni 364 paragrafi 1.3 të KPPRK, pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

### **Gjetjet e gjykatës në raport me aktgjykimin:**

Gjykata në raport me këtë çështje penale dhe aktin akuzues të parashtruar në këtë çështje penale, së pari do ta shtjelloj: vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje penale e për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor; cilësimin juridik të veprës penale në raport me gjetjet të cilat kanë rezultuar me administrimin e provave në këtë çështje penale; provat e faktet të cilat kanë sjellë deri tek gjetja fajtor e të akuzuarit; pretendimet e mbrojtjes për çështjet e caktuara të parashtruara në fjalë përfundimtare; çështjen e dënimit dhe të shpenzimeve procedurale.

### **Gjendja faktike dhe cilësimi juridik në raport me gjendjen faktike:**

Gjykata, në këtë çështje penale ka vetëtuar gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në një përshkrim të shkurtër ka vërtetuar se i akuzuari A.N., brenda periudhës kohore nga viti 2018 e deri me datë 09.02.2019 ka sjellë së paku katër herë ngarkesa të narkotikut të llojit “marihuanë” deri tek (tashmë i dënuari) B.S., respektivisht në fshatin ... të komunës së F., ku A.N., ndër këto katër herë të sjelljes së narkotikut ka sjellë edhe me datë 17.01.2019 e me datë 08.02.2019, ku këtë narkotikë e ka sjellë nga Republika e Shqipërisë për në fshatin ... të komunës së F., deri tek tashmë i dënuari B.S. me automjetet: kamionetë ngjyrë të bardhë me targa të Shqipërisë dhe kamionetë ngjyrë portokalli.

Prokuroria Speciale, me rastin e ngritjes së aktit akuzues ka akuzuar të akuzuarin, A.N., për veprën penale krim i organizuar nga neni 283 paragrafi 1 e lidhur me nenin 273 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të KPRK.

Prokuroria Speciale, në shqyrtim gjyqësor-në fjalën përfundimtare, sa i përket cilësimit juridik të veprës penale për të cilën është akuzuar i akuzuari A.N. ka theksuar se:

- “Pasi që kjo çështje është kthyer në ri-gjykim me Vendim të Gjykatës së Apelit APSnr.13/22 të datës 15.09.2022, vetëm për të akuzuarin A.N., në fillim të këtij shqyrtimi gjyqësor prokuroria e kishte njoftuar gjykatën se bazuar në dispozitivin ligjor të nenit 406 të KPPRK, atëherë në fuqi, ku përcakton se në procedurën e rigjykimit në gjykatë themelore sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, *Gjykata themelore të cilës i është dërguar lënda për gjykim procedon në bazë të aktakuzës së mëparshme*, prokuroria në këtë fazë të procedurës ka mbetur në tërësi pranë Aktakuzës së datës 27.09.2019 në raport me të akuzuarin A.N.”;

- “Lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet i akuzuari A.N., prokuroria e njofton gjykatën se bazuar në nenin 397 dhe nenin 351 të KPPRK, ri-cilëson veprën penale ndaj këtij të akuzuari dhe atë nga vepra penale për të cilën është ngritur aktakuza ndaj tij dhe të bashkakuarve të tjerë, e që ishte krimi i organizuar i sanksionuar me nenin 283 paragrafi 1 lidhur me nenin 281 nën paragrafi 1.9 e lidhur me veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja apo shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope, sanksionuar me nenin 273 paragrafi 2 të KPK, në veprën penale të kryer “në vazhdimësi blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK, lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 të KPRK dhe nenin 81 të KPRK”;
- “Këtë ri-cilësim prokuroria e bën duke pasur parasysh faktin se ndaj të bashkë-akuzuarve të A.N., tashmë ekziston një aktgjykim i plotfuqishëm në bazë të të cilit është ri-cilësuar vepra penale për të cilën ishte ngritur aktakuza, ri-cilësim ky i cili shkon në dobi edhe të të akuzuarit A.N., bazuar në parimin *Beneficium cohaesionis* të paraparë në dispozitat ligjore të KPPRK, si dhe bazuar në faktet e çështjes të vërtetuara nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në mbështetje të nenit 351 të KPPRK”.

Në raport me ri-cilësimin juridik të veprës penale dhe atë të bërë sipas detyrës zyrtare nga gjykata, gjykata e ka bërë këtë ri-cilësim mbi bazën dhe faktet se:

- Prokuroria Speciale në fjalën përfundimtare të saj ka theksuar se kërkesa e prokurorisë (bazuar edhe në vendimin e shkallës së dytë) është që të procedohet akti akuzues ashtu si është parashtruar dhe atë në tërësi akti akuzues me të gjitha elementet përbërëse të tij, ndërsa në të kundërtën ka bërë ri-cilësimin e veprës penale;
- Fakti se Prokuroria Speciale, ka qëndruar në tërësi pranë aktit akuzues të parashtruar ndaj të akuzuarit A.N. dhe atë me këtë akt akuzues i akuzuari është akuzuar për veprën penale të krimit të organizuar, ndërsa në anën tjetër prokuroria ka bërë ri-cilësimin e veprës penale pa bërë asnjë ndryshim/harmonizim të aktit akuzues, respektivisht harmonizim të përshkrimit faktik të veprës penale me ri-cilësimin juridik të saj, gjykata konsideron se ri-cilësimi i veprës penale pa harmonizuar dispozitivin e aktit akuzues është ri-cilësim jo i plotë dhe i pa mundur për të vepruar nga gjykata;
- Gjykata, marrë në konsideratë se në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, e jo për veprën penale të krimit të organizuar, ka bërë ri-cilësimin e veprës penale nga vepra penale e krimit të organizuar në veprën penale për të cilën është gjetur fajtor i akuzuari, e po ashtu duke bërë harmonizimin e dispozitivit të këtij aktgjykimi (përshkrimit faktik të veprës penale) me cilësimin/ri-cilësimin juridik të saj;
- Marrë në konsideratë se kjo çështje penale është e ndërlidhur me çështjen penale vetëm se të gjykuar sipas vendimit të formës së prerë (Aktgjykimi PS.nr.39/2019 të datës 26.02.2021), e ku të gjithë të akuzuarit tjerë nuk janë gjetur fajtor për veprën penale sipas aktit akuzues, por për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe i akuzuari A.N., gjykata ka konsideruar

se në rastin konkret nuk janë përmbushur elementet e veprës penale të krimit të organizuar nga neni 283 të KPRK, por të veprës penale në vazhdimësi blerja, posedimi dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2 të KPRK, lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 të KPRK dhe nenin 81 të KPRK.

Gjykata, sa i përket ri-cilësimit të veprës penale për shkak të mos gjetjes së veprës penale të krimit të organizuar, do ta bëjë elaborimin më poshtë.

Për të ekzistuar vepra penale e krimit të organizuar, nevojitet të përmbushen disa parakushte apo karakteristika, të cilat karakteristika janë të akceptuara edhe në përkufizimin ligjor të veprës penale të krimit të organizuar nga nen 283 i KPRK.

Pra, për të ekzistuar krimi i organizuar, duhet të përmbushen katër karakteristika mandatore, pa të cilat nuk mundë të ekzistoj krimi i organizuar si dhe së paku dy nga karakteristikat alternative të cilat e formojnë krimin e organizuar. Këto katër karakteristika bazë të krimit të organizuar janë: **1)** përfshirja e tre apo më shumë personave si grup i organizuar kriminal; **2)** për periudhë të gjatë ose të pacaktuar kohore; **3)** të dyshuar apo të dënuar për vepra penale të rënda (për të cilat përcaktohet dënimi me 4 (katër) vite burgim apo më shumë dhe **4)** me qëllim të përfitimit material apo të pushtetit <sup>4</sup>.

Përpos karakteristikave mandatore për të ekzistuar krimi i organizuar, grupi i ekspertëve të KE, ka përcaktuar edhe karakteristikat alternative e të cilat duhet së paku dy nga to të plotësohen. Ku si karakteristika alternative konsiderohen: **1)** të ketë një rol ose detyrë të veçantë për secilin anëtar të grupit; **2)** përdorin ndonjë formë disipline ose kontrolli të brendshëm; **3)** përdorin dhunë ose forma tjera frikësuese; **4)** ushtrojnë ndikim tek politika, mediat, administrata publike, organet e zbatimit të ligjit; **5)** përdorin strukturë tregtare ose të ngjashme me biznesin; **6)** janë të përfshirë në pastrim parash; **7)** operojnë në nivel trans-nacional.

Pra këto janë karakteristikat-elementet kyçe që duhet të plotësohen për ekzistimin e veprës penale të krimit të organizuar, të cilat karakteristika-elemente i kanë akceptuar dhe instrumentet me të rëndësishme ndërkombëtare në definimin e krimit të organizuar, instrumentet e theksuara dhe në referencë të këtij aktgjykimi.

Me rëndësi është të theksohet se këto elemente a janë plotësuar në rastin konkret, respektivisht në veprimet e të akuzuarit në këtë çështje penale. Në raport me faktin se a janë plotësuar këto elemente në veprimet e të akuzuarit, gjykata do i elaboroj më poshtë:

- Nuk ka dilemë se në rastin konkret i akuzuari A.N., ka qenë i përfshirë në këtë vepër penale me më shumë se tre persona, por nuk kemi të bëjmë me grup-kriminal të organizuar, por me një grup të akuzuarish të cilët kanë ndërmarrë veprime të kohëpaskohshme në kryerjen e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor. Për të ekzistuar krimi i organizuar grupi prej

<sup>4</sup> Lis of Characteristics of Organized Crimes / Experts of Council of Europe - Lista e Karakteristikave të Krimit të Organizuar / Ekspertët e Këshillit të Evropës.

UN Convention on Transnational Organized Crime (General Assembly Resolution 55/25 of 15 November 2000) - Konventa e OKB për Krimin e Organizuar Transnacional (Rezoluta 55 /25 e 15 nëntor 2000 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB.

<https://www.unodc.org/e4j/en/organized-crime/module-1/key-issues/activities-organization-composition.html>

tre e më shumë persona duhet të jetë grup kriminal i organizuar e jo një përbërje e thjeshtë prej tre e më shumë personave<sup>5</sup>;

- Grupi kriminal i organizuar<sup>6</sup> është përcaktuar si grupi strukturuar i tre e më shumë personave i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale, ndërsa në rastin konkret, gjykata, nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se nuk kemi pasur një grupi mirëfilli të organizuar me një strukturë udhëheqëse, ku definitivisht është ditur se kush është lideri i grupit, kush jep urdhër, kush janë zbatuesit e këtyre urdhrave dhe cilat janë detyrat e ndara për çdo njërin anëtar të grupit;
- Nga provat e administruara (përgjimi i telekomunikimeve dhe deklaratat e dëshmitarëve), nuk vërtetohet se kush është lideri i grupit i cili jep urdhra dhe se anëtarët tjerë t'i binden urdhrave të tij. Të gjitha këto urdhra të pretenduar nga organi akuzës, më shumë ngjasojnë në marrëveshje e komunikime të të akuzuarve brenda grupit. Nga provat e potencuar (përgjimi i telekomunikimeve të të akuzuarve tani më të dënuar ndërmjet vete dhe me të dyshuarin në arrati Z.K.), shihet qartë se në raste të caktuara jo vetëm se i dënuari Xh.S., jep udhëzime, por edhe të tjerët japin udhëzime (urdhra të pretenduar) në drejtim të kryerjes së veprës penale. Këto udhëzime shpesh i jep i dyshuari në arrati Z.K., ku në komunikime shihet qartë se ai shpesh i jep udhëzime tani të dënuarit Xh.S., J.B., B.S., por jo edhe të akuzuarit A.N., që të konsiderohet se ka qenë një strukturë e organizuar;
- Mos ekzistimin e një strukture të organizuar të grupit kriminal të organizuar, e vërteton fakti se nuk ka ekzistuar ndonjë disiplinë, kontroll brenda grupit, që të jep të kuptojmë se në rast të mos zbatimit të urdhrave të dhëna nga udhëheqësi i grupit do të ketë pasoja, që është karakteristikë e grupit kriminal të organizuar dhe kriminit të organizuar. Të akuzuarit e tjerë përpos të akuzuarit A.N., pjesa më e madhe e tyre, janë njohur ndërmjet vete si rezultat i vendbanimit të përbashkët apo se kanë vijuar shkollimin e përbashkët, ku kjo ndërlikohje ka bërë që të njëjtit të veprojnë në cilësi të një grupi të disa personave në drejtim të kryerjes së një vepre penale në vazhdimësi, por jo se këtë grup ta ketë ndërlidhur fakti i strukturës së organizuar, urdhër-dhënies dhe zbatimit të urdhrave;
- I akuzuari A.N., duke përfshirë edhe tani më të dënuarit, kanë vepruar për një periudhë kohore të limituar dhe atë përshtetur sikurse në dispozitiv të aktgjyqimit, mirëpo nuk mund të thuhet se kanë vepruar për një periudhë të gjatë kohore për ta ushtruar veprimtarin kriminale, respektivisht nuk kanë vepruar për një periudhë kohore e cila mund të cilësohet si ndërmarrësi kriminale<sup>7</sup> në drejtim të kryerjes së një vepre të një natyre të caktuar apo veprave të natyrave të ndryshme kriminale, me qëllimin e përfitimit material;
- I akuzuari A.N., nuk është njohur (nuk i ka njohur) me të gjithë të akuzuarit tjerë tani të dënuar. I akuzuari A.N., është njohur me B.S., mirëpo jo edhe me të tjerët që të konsiderohet se ka qenë një grup kriminal i organizuar. Nga provat e administruara në këtë çështje penale,

<sup>5</sup> Neni 2 i Aneksit të Konventës së OKB për Krimin e Organizuar Trans-nacional.

<sup>6</sup> Ndërmarrësi kriminale - criminal enterprise e definuar sipas Konventës së OKB.

del se A.N. e ka furnizuar me narkotik të akuzuarin tani të dënuar B.S., ndërsa B.S. me tani të dënuarin G.K., ta kenë sistemuar narkotikun me qëllim të furnizimit me narkotik të akuzuarve (të dënuarve) tjerë, e të akuzuarit (të dënuarit tjerë) Xh.S., J.B., i arratisuri Z.K., e të tjerët të kenë pasur marrëveshje spontane ndërmjet vete për transportimin e këtij narkotiku, por jo ndonjë strukturë të organizuar kriminale ku i akuzuari A.N. ta ketë pasur ndonjë detyrë të caktuar brenda grupit;

- Gjykata me plotë kuptim, ka vërtetuar se në rastin konkret nuk kemi pasur të bëjmë me ndonjë grup të organizuar kriminal, por me të akuzuarin A.N. e të akuzuar e tjerë tani më të dënuar të cilët disa prej tyre as fare nuk janë njohur ndërmjet vete, e disa prej tyre kanë vepruar së bashku por pa ndonjë organizim të mirëfilli në formë të krimit të organizuar;
- Marrë në konsideratë të gjitha të theksuarat më lartë dhe faktin e potencimit në fjalën përfundimtare të Prokurorisë Speciale se mbështet tërësisht Aktgjykimin PS.nr.39/2019 të datës 26.02.2021, me të cilin aktgjykim është bërë ri-cilësimi i veprës penale për të akuzuarit e tjerë tani më të dënuar, gjykata konsideron se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprë penale të krimit të organizuar, por me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari A.N.;
- Andaj, gjykata ka bërë ri-cilësimin e veprës penale, nga cilësimi juridik i bërë nga organi akuzës, vepra penale e krimit të organizuar nga neni 283 paragrafi 1 e 2 lidhur me nenin 273 paragrafi 2 e nenin 281 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.9 të KPRK, në veprën penale nga neni 273 paragrafi 2 lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 dhe nenin 81 të KPPRK;
- Përpos faktit se gjykata nuk ka gjetur prova se i akuzuari A.N. së bashku me të akuzuarit tjerë (tanimë të dënuar), kanë vepruar si grup i organizuar kriminal, ka gjetur se në cilësimin juridik të veprës penale, organi akuzës ka akuzuar të akuzuarit për veprën penale të krimit të organizuar nga neni 283 lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të KPRK. Neni 281 i KPRK, përcakton dënime për raste të rënda të veprave penale nga kapitulli i veprat me narkotikë dhe atë duke pretenduar në sasinë e madhe të narkotikut. Mirëpo, marrë në konsideratë se organi akuzës i ka akuzuar të akuzuarit për veprën penale të krimit të organizuar për të cilën përcaktohet me ligj vetëm minimumi i dënimit me burgim, ndërsa si dënim maksimal mund të shqiptohet maksimumi i dënimit me burgim e deri ne 25 vjet burgim, ndërsa sipas nenit 281 të KPRK, dënimi maksimal për raste të rënda të veprave penale me narkotik është maksimumin 15 vjet, atëherë nuk ka arsyeshmëri që i akuzuarit të akuzohen sipas nenit 281 të KPRK, derisa neni 283 (krim i organizuar) i KPRK, ka dënim më të ashpër se neni 281 i KPRK. Gjykata, meqenëse nuk ka gjetur se ekziston krim i organizuar në këtë rast penal, ka ri-cilësuar veprën penale në nenin 273 paragrafi 2 lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.9 të KPRK, pasi që të akuzuarit kanë vepruar si grup dhe sasia e narkotikut ka qenë sasi e konsiderueshme-e madhe.

Fajësia e të akuzuarit në raport me gjendjen faktike:

Deri më tani në arsyetim të aktgjykimi është shtjelluar gjendja faktike të cilën gjykata e ka provuar lidhur me ri-cilësimin juridik të veprës penale.

Ndërsa në pjesën e mëtejme të aktgjykitimit do të shtjellohet gjendja faktike në raport me të akuzuarin, fajësinë e tij dhe provat me të cilat është vërtetuar fajësia e tij.

Nuk ka mëdyshje se nga provat e administruara si: përgjimi i telekomunikimeve; deklaratat e dëshmitarëve; raportet e vëzhgimit; ekspertizat e narkotikut dhe shkresat e tjera të lëndës, është vërtetuar se cilat janë veprimet e të akuzuarit të cilat i ka ndërmarrë në funksion të kryerjes së veprës penale, respektivisht cilat veprime të të akuzuarit ngërthejnë në vete përgjegjësinë penale, e për të cilat gjykata edhe e ka gjetur fajtor.

Në këtë çështje penale ky i akuzuar është gjetur fajtor se të paktën katër herë ka sjellë substanca narkotike të llojit "Marihuanë" nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe datat 17.01.2019 dhe 08.02.2019. Sasinë e narkotikut e ka sjellë nga Republika e Shqipërisë tek i akuzuari tanimë i dënuar B.S. në fshatin ... të komunës së F. dhe atë me automjete, kamionetë ngjyrë të bardhë me targa të Shqipërisë dhe kamionetë ngjyrë portokalli.

Këtë akuzë-fakt, i akuzuari A.N. e ka kundërshtuar me pretendimin se i njëjti asnjëherë nuk ta ketë furnizuar me narkotik të akuzuarin tanimë të dënuar B.S., as që e njuh B.S. dhe as që të ketë shkuar ndonjëherë në fshatin ... të komunës së F., fshat ku banon B.S., mirëpo gjykata me provat e administruara ka vërtetuar të kundërtën.

Gjykata këtë fakt e ka vërtetuar me administrimin e provave të poshtë-theksuar:

- Është fakt notor-i pakontestueshëm që i akuzuari A.N., është nga Republika e Shqipërisë, respektivisht banor i T. Këtë fakt e dëshmon vet i akuzuari në deklaratimet e tij e po ashtu dhe dokumentet e udhëtimit të përdorura nga ai. Gjykata, faktin se i akuzuari është nga Republika e Shqipërisë, nuk e ka konsideruar si fakt që e mbështet dhe pretendimin se i njëjti të ketë transportuar edhe narkotik. Sa i përket faktit se i akuzuari A.N., është marrë me transportim të narkotikut, e vërteton edhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti Special në Prishtinë, Aktgjykimi PS.nr.42/2020 i datës 27.11.2020. Në këtë çështje penale të përfunduar me këtë aktgjykim të formës së prerë, i akuzuari A.N., ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, është shpallur fajtor dhe dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite e 10 muaj;
- I akuzuari A.N., faktin se të jetë marrë me transportim të narkotikut të llojit "Marihuanë" e ka pohuar edhe vetë. Në këtë çështje penale i njëjti të ketë theksuar se për veprën penale për të cilën është gjykuar, e ka pranuar fajësinë, ta ketë pranuar fajësinë sepse të njëjtën e ka bërë, ndërsa për veprën penale e cila është objekt shqyrtimi i këtij aktgjykimi ka deklaruar se nuk ka fare të bëjë me të dhe me të akuzuarit e tjerë.<sup>8</sup> Nga ky vet-pohim i të akuzuarit A.N., pa mëdyshje gjykata ka vërtetuar se i akuzuari të jetë marrë me transport të narkotikut dhe atë të llojit "Marihuanë";

<sup>8</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, ku i akuzuari A.N. ka dhënë deklaratën mbrojtëse të tij para Trupit Gjykses, në procesin e parë dhe të fundit të shqyrtimit të çështjes.



- Dëshmitari A.S. (i mitur-djalë i të akuzuarit tani më të dënuar B.S.), në deklaratimet e tija ka pohuar faktin se B.S., të ketë pranuar narkotik nga i akuzuari A.N. dhe atë duke përshkruar saktë se si e ka pranuar narkotikun, si ta ketë ndihmuar babain e tij (B.S.), për ta shkarkuar narkotikun nga mjete transportues dhe për ta sistemuar në një shtëpi të braktisura përballë shtëpisë së tyre në fshatin ... të komunës së F.;
- Dëshmitari A.S., në deklaratimet e tija i ka dhënë dy deklaratë në polici (në hetuesi) dhe atë me datë 06.03.2019 dhe me datë 12.06.2019. Në deklaratën e parë ky dëshmitar ka deklaruar në tërësi për rastin, ndërsa në deklaratën e dytë e cila është marrë me autorizim të prokurorisë, i njëjti ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë më herët, pra deklaratës së datës 06.03.2019;

Ky dëshmitar në deklarinimin e tij ka deklaruar se "me datë 08.02.2019, më ka thirr në telefon babi dhe më tha qeli dyert e oborrit të një shtëpisë që gjendet përball shtëpisë tonë, unë kur dola e kam pa kamionetën me ngjyrë të bardhë e cila hyri në oborr dhe i kam mbyll dyert. Aty kam qenë unë babi dhe personi nga Shqipëria, ku kemi hequr shumë paketime të mbështjella me najlon që ishin të fshehura në tavanin e mbulesës së kamionetës ..., personi nga Shqipëria i nxirrte paketimet dhe i gjuante në tokë, ndërsa unë dhe babi i kemi shti me një dhomë të asaj shtëpisë ..., pasi që i kemi hek të gjitha paketimet, kamioneta ka ecur për në fshatin S., kurse unë në shtëpi, e babi ka dal...". Nga ky deklarinim i këtij dëshmitari vërtetohet qartë se B. S., të ketë pranuar narkotik nga persona nga Shqipëria dhe atë narkotiku të jetë transportuar me kamionetë;

I akuzuari A.N., a e ka sjellë narkotikun, dëshmitari A.S., në deklaratimet e tija me datë 06.03.2019, respektivisht në pyetjen e parashtruar se a mund ta përshkruani vozitësin e kamionetës, i njëjti thekson se "ka qenë rreth 40-50 vjeç me trup i shëndoshë, barkun e ka pas të madh". Dëshmitarit po ashtu i është prezantuar një fotografi nga video-kamerat e pikës kufitare "Q. P.", respektivisht i është prezantuar fotografia e të akuzuarit A.N., ku dëshmitari A.S. e konfirmon se është ai person i cili ka sjellë drogë me kamionetë të bardhë. Pra, identifikimi i të akuzuarit A.N., është bërë nga dëshmitari A.S. dhe atë me prezantimin e fotografive ku ky dëshmitar ka identifikuar të akuzuarin A.N.;

Dëshmitari po ashtu në deklarinimin e tij të bërë me datë 06.03.2019, në pyetjen e parashtruar se në fund të muajit Janar a kanë sjellë drogë, i njëjti përgjigjet se "po nuk e di saktë datën, por ka qenë personi i njëjtë sikurse herën e fundit, mirëpo ka qenë me kamionetë me ngjyrë portokalli, pa mbulesë me targa të Shqipërisë dhe se ka sjellë rreth 150 paketime";

- Nga deklaratë e këtij dëshmitari (deklaratimet e potencuar më lartë), pa mëdyshje vërtetohet se i akuzuari tani më i dënuar B.S., ka pranuar sasi të narkotikut nga disa persona nga Republika e Shqipërisë, se dëshmitari A.S., t'i ketë ndihmuar për ta shkarkuar e sistemuar narkotikun dhe se të paktën dy herë nga katër herët që ka sjellë narkotik i akuzuari A.N., dëshmitari A.S., t'i ketë ndihmuar në shkarkimin dhe sistemimin e narkotikut, ku për këtë angazhim t'i ketë pranuar nga 100 Euro, nga babai i tij, por që i njëjti më vonë prapë t'ia ketë marrë këto para;
- Faktin se A.N., njëherë nga ditët kritike që ka transportuar narkotik, të ketë lëvizur në pikë kufitare nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Kosovës, e dëshmojnë dhe hyrje-

daljet e kufirit, respektivisht BMS e menaxhimit të kufirit, ku nga këto të dhëna del se A.N., me datën 17.01.2019, ka kaluar kufirin me automjet kamionetë me targa të Shqipërisë ...;

- Nga provat e administruara në këtë çështje penale, ka rezultuar se personi i cili ka sjellë narkotikun nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Kosovës, është personi me pseudonimin "Ç." dhe ka një moshë afër pesëdhjetë vjeçare. I akuzuari A.N., por edhe të akuzuarit tjerë në këtë çështje penale kanë mohuar se A.N. të ketë qenë personi i cili e ka sjellë narkotikun dhe se të ketë qenë rreth kësaj moshe. Marrë në konsideratë deklaratën e dëshmitarit A.S., i cili po ashtu e ka përshkruar personin nga Shqipëria i cili e ka sjellë narkotikun si person në moshë të pesëdhjetave, shihet qartë se kemi të bëjmë me të akuzuarin A.N., pra personin e njëjtë të cilin A.S. e përshkruan si person të moshës së pesëdhjetave;
- I akuzuari A.N., në çdo moment e ka mohuar se t'i ketë njohur të akuzuarit e tjerë të këtij rasti, po ashtu ka mohuar se nuk është personi me nofkën "Ç.", mirëpo gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar të kundërtën se A.N., është personi me nofkën "Ç." i cili e ka sjellë narkotikun tek B.S., e që ky narkotik më tej të transportohet me qëllim shitje;

Fakt i pakontestueshëm është se tani i dënuari B.S., ka përdorur numrin e telefonit 049..., këtë fakt e ka pohuar edhe vet B.S.. B.S., gjatë gjithë kohës ka komunikuar me numrin 049..., ku me këtë numër komunikojnë për organizmin e pranimit dhe dorëzimit të narkotikut nga personi "Ç." nga Shqipëria, për në shtëpinë e B.S. Gjykata për ta vetëtuat se numri i telefonit 049..., a është shfrytëzuar nga personi me nofkën "Ç." dhe se personi me nofkën "Ç." a është i akuzuari A.N., ka konsideruar edhe deklarinimin e pranimit të fajësisë nga A.N. në çështjen penale të veçuar që është udhëhequr me Aktgjykimin PS.nr.42/2020. Në këtë proces gjyqësor i akuzuari A.N., ka pranuar fajësinë dhe këtë fajësi e ka pranuar për gjendjen faktike ashtu si është shpallur fajtor, po ashtu pa i kundërshtuar provat e aktit akuzues në këtë çështje penale, ku ndër provat e parashtruara janë dhe përgjimet e telekomunikimeve të numrit 049..., i cili numër i dedikohet A.N., ku i akuzuari A.N., këtë fakt (se numri është i tij) nuk e ka kundërshtuar me rastin e pranimit të fajësisë sipas Aktgjykimit PS.nr.42/2020;

Nga vërtetimi i këtij fakti, vërtetimi i faktit se numri 049-854-094 i përket të akuzuarit A. N., e ku B.S. tani më i dënuar në këtë çështje penale, ka komunikuar me këtë numër lidhur me narkotikun dhe atë me personin "Ç." këtu A.N., konsiderohet se i akuzuari A.N., është personi "Ç." i cili e ka sjellë narkotikun tek B.S.;

- Marrë në konsideratë: deklarinimet e dëshmitarit A.S., identifikimin e të akuzuarit A.N. nga A.S., hyrje daljet e kufijve (BMS); pranimin e fajësisë për veprën penale e cila është udhëhequr sipas Aktgjykimit PS.nr.42/2020 dhe përgjimit të telekomunikimeve, gjykata konsideron dhe ka vërtetuar se i akuzuari A.N., është personi me pseudonimin "Ç." i cili e ka furnizuar (të paktën katër herë ) me narkotik tani të dënuarin B.S., ku B.S. më pas këtë narkotik ua ka dhënë për transportim të akuzuarve (tani më të dënuar) tjerë në këtë çështje penale;
- Dëshmitari A.S., në deklarinimet e tija në shqyrtim gjyqësor (shqyrtimin e parë në këtë çështje penale, pasi që palët janë dakorduar të administrohen deklaratat e dëshmitarëve pa i dëgjuar në shqyrtim gjyqësor), ka mohuar të gjitha ato të cilat i ka deklaruar në fazat fillestare

hetimore dhe atë me pretendimin se ndaj tij është përdorur forcë e dhunë. Ka mohuar të gjitha faktet, duke përfshirë dhe faktin se i akuzuari A.N., ta ketë sjellë narkotikun, të cilin fakt e ka potencuar në deklaratimet e tija në hetuesi e po ashtu e ka identifikuar edhe të akuzuarin A.N.. Gjykata për ta vërtetuar këtë fakt, ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve policët hetues të rastit (I. B. dhe V. G.), po ashtu ka dëgjuar edhe punëtorin social, zyrtarin N. V., i cili ka pohuar se deklaratimet e dëshmitarit të mitur A.S., janë dhënë në harmoni me ligjin dhe se gjatë gjithë kohës sa ai është intervistuar, ky si punëtor social ka qenë prezent dhe se intervistimi ka shkuar në harmoni me ligjin pa pasur asnjë parregullsi. Mbi këto të gjetura, gjykata dëshmitarit A.S., respektivisht deklaratimeve të tij në shqyrtim gjyqësor nuk ua ka dhënë besimin e plotë, posaçërisht nuk ua ka dhënë besimin e plotë deklaratimeve të tij në raport me të akuzuarin A.N.;

- Nga ekspertimi i bërë nga Agjencia Kosovës për Forenzikë, respektivisht Raporti i ekspertimit të narkotikëve me shenjen AKF/2019... i datës 23.05.2019, është vërtetuar fare qartë se materiali i sekuestruar tek vendi i quajtur "U. e G." dhe në depon e mobilierisë "N." është substancë narkotike e llojit "Marihuanë". Këtë narkotik si edhe u theksua më herët, gjykata ka vërtetuar se e ka sjellë i akuzuari A.N.;

Nga deklarata-procesverbali mbi identifikimin e personit, nga dëshmitari A.S., datës 15.08.2019, është vërtetuar se i pandehuri A.N., ishte personi që e kishte dërguar narkotikun tek shtëpia e të pandehurit B.S. me dy kamioneta të ndryshme me targa të shtetit Shqiptar, ky dëshmitar gjithashtu ka identifikuar edhe të akuzuarit tjerë tashmë të dënuar dhe të pandehurin Z.K. që ndodhet në arrati, si dhe automjetet që kishin drejtuar të njëjtit "VW ..." dhe "VW ..." me targa të Sh. si personat që kishin shkuar në shtëpinë e tij, për të marrë narkotikun dhe për ta transportuar më pas në Republikën e Maqedonisë Veriore.

Nga pjesa e arsytimit të deritanishëm të këtij aktgjykimi, është shtjelluar se si i akuzuari A.N., ka sjellë narkotikun deri tek i akuzuari tani më i dënuar B.S.. Ky narkotik nuk ka përfunduar tek B.S., por nga ai tek të akuzuarit e tjerë tani më të dënuar të kësaj çështje penale (të akuzuarit Xh.S., G.K., J.B., F.B, F.B., D.S. e H.B., të cilët tani më janë të dënuar me vendim të formës së prerë, duke u refuzuar mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike) të cilët kanë tentuar disa herë të njëjtin narkotik ta dërgojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mirëpo nuk kanë mundur për shkak të kontrolleve rrugore e kufitare policore.

Gjykata, në këtë aktgjykim do të bëjë një elaborim të shkurtër të provave dhe fakteve të vërtetuara në raport me të akuzuarin A.N. dhe të akuzuarit tjerë se si sasinë e narkotikut të sjellë nga A.N., kanë bërë përpjekje për ta transportuar në Maqedoninë Veriut, ku për të akuzuarit të cilët tani më të dënuar do të bëhet një elaborim më i përgjithshëm pasi që çështja e këtyre të akuzuarve vetëm se ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Me datë 03.10.2018, të akuzuarit Xh.S., J.B., F.B, F.B., D.S. e H.B. (si është vërtetuar edhe me aktgjykimin e formës së prerë se disa nga të akuzuarit kanë përcjellë rrugën e disa kanë transportuar narkotikun), me automjetin "O. F." pa targa, transportojnë narkotik në sasi prej 108 kg me qëllim shitje deri afër kufirit shtetëror Republika e Kosovës-Republika e Maqedonisë së Veriut, duke kaluar ilegalisht kufirin jashtë vendkalimit kufitarë dhe pasi u vënë re nga Policia Kufitare e Republikës së Kosovës, hodhën nga automjeti në tokë narkotikun te vendi i quajtur "U. e G." e pastaj hynë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa Policia

Kufitare e Republikës së Kosovës, merr narkotikun e llojit "Marihuanë" në sasi prej 108 kg dhe e sjell në Stacionin Policor në H.të E.

Fakti se narkotiku i sjellë (furnizuar) nga i akuzuari A.N. është tentuar të transportohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është vërtetuar edhe me Aktgjykimin PS.nr.39/2019 të datës 26.02.2021, me të cilin aktgjykim të formës së prerë është vërtetuar se të akuzuarit B.S., Xh.S., J.B., F.B, F.B., D.S. e H.B., kanë tentuar transportimin e narkotikut dhe në pamundësi për ta transportuar një sasi e kanë hedhur nga vetura "O. F."

Faktin e hedhjes së narkotikut të sjellë nga A.N., hedhjen nga vetura "O. F" dhe tentimin për ta dërguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e vërtetojnë edhe faktet e provat:

- Fakt i pa kontestueshëm është se me datë 03.10.2018, Policia Kufitare në H. e E., gjatë vëzhgimit të kufirit kanë hetuar kalimin ilegal të automjetit "O. F" dhe disa personave. Pasi që të akuzuarit vënë re se janë hetuar nga policia hedhin çantat me lëndë narkotike tek vendi i quajtur "U. G.", ikin nga vendi i ngjarjes, ndërsa narkotiku sekuestrohet nga policia kufitare. Faktin se është gjetur narkotik në sasi prej 108 kg, nga Policia Kufitare në vendin e quajtur "U. e G.", gjykata e ka vërtetuar me Raportin e forenzikës së vendit të ngjarjes me shenjën VN... dhe shenjën e policisë 2018... i datës 03.10.2018;
- Nga Raporti i forenzikës VN... dhe shenjën e policisë 2018..., vërtetohet se me datën 03.10.2018, rreth orës 23:40, forenzika ka dalë në vendin e ngjarjes dhe se është njoftuar se njësia kufitare patrulluese e vijës së gjelbër në fshatin D. të zonës kufitare të H. të E., kishin hasur në 5 çanta në të cilat ka pasur sasi të narkotikut e cila sasi është sekuestruar;
- Gjykata nga provat e administruara, ka vërtetuar faktet se të akuzuarit pjesa më e madhe e tyre janë me vendbanim në zonën kufitare, ku në ditën kritike (03.10.2018), këta të akuzuar kanë transportuar narkotik me automjetin "O. F." pa targa me ngjyrë të bardhë. Ku i akuzuari D.S. sipas kërkesës së J.B., ka bërë vëzhgimin e rrugës dhe se automjetin "O. F." e kanë drejtuar dy persona të tjerë të cilët nuk i ka parë se kush ishin dhe se nga raporti i policisë (forenzikës së policisë), është vërtetuar se personat e dyshimtë, këtu të akuzuarit pasi që janë vënë re nga policia e kanë hedhur narkotikun, respektivisht çantat me narkotik nga automjeti në vendin e quajtur "U. G." dhe vet të kenë ikur për në Maqedoni, pas gjetjes së këtyre çantave nga policia është vërtetuar se në to ka sasi të narkotikut prej 108 kg;
- Përmes mesazheve por edhe me biseda me zë, vërtetohet qartë komunikimi i këtyre të akuzuarve lidhur me vëzhgimin e terrenit gjatë bartjes së narkotikut në zonën kufitare dhe atë duke e udhëzuar njëri tjetrin se nga t'ia mbajnë që t'i shmangen kontroleve policore, sikurse duke theksuar në komunikime " ... manja tërma ... të dalin andej urës ... kur vini në kufi bani gati dokumentat ..." etj. Këto komunikime edhe të akuzuarit nuk i mohojnë gjatë dhënies së mbrojtjes së tyre, por e mohojnë se të kenë bartur e transportuar narkotik, ndërsa në procesin penal të zhvilluar ndaj të akuzuarve të cilët tanimë janë të dënuar me vendim të formës së prerë, është vërtetuar se të njëjtët kanë transportuar narkotik të llojit "Marihuana" e jo diç tjetër;

- Përmes komunikimit, respektivisht përmes përgjimeve të telekomunikimeve të numrit të akuzuarit Xh.S. (045...), vërtetohet se i njëjti komunikon vazhdimisht me telefon me të akuzuarin tjetër D.S. (044...) dhe të njëjtin e udhëzon se si ta përcjell rrugën gjatë transportimit të narkotikut, se duhet ta marrë edhe F.B. dhe së bashku të shkojnë më fshatin S., ku sistemohej narkotiku në shtëpinë e Z.K., po ashtu e udhëzonte se në pikën kufitare duhet t'i qëndroj me automjet nga mbrapa J.B. i cili po transportonte narkotikun. D.S., vazhdimisht e njoftonte të akuzuarin Xh.S. se ku ndodheshin patrullat policore. Përpos që Xh.S., ka komunikuar me D.S., ka komunikuar edhe me J.B. (me numër telefoni 049...), ku nga këto komunikime kuptohet se J.B. në momentin e transportimi të narkotikut me automjet, nuk ishte i vetëm, ai kohë pas kohe shoqërohej nga F.B, kjo kuptohet nga komunikimet e tyre si: “ti qëndroi në bisht apo mbrapa automjetit të Xh.” e “kqyre F. 50 metra larg rri”. Kur i afrohen pikës kufitare komunikojnë ndërmjet vete si: “mani dokumentet ne xhep, mos u garen mas dokumentave aty”; “ e lejna hazër se ai veç i hyp, t'i zhdryp megjuzon t'i edhe hec” dhe “ti qetash zhdryp, i hyp F., F. i tham nalet ne megjuzon, t'i i hyp kerrit hec”. Nër rastin konkret se kanë qenë edhe të tjerët të involvuar tregojnë po ashtu transkriptet e bisedave edhe me F.B., ku Xh.S. i thot J.B. se “qe tu e përcjell jam unë, kontaktoni me F. njani se jam tu e kshur une Sh.” dhe “le të dale te Ura posht se F. e sheh krejt me pas xhip (policisë) te flamuri te poshtë, mos të rrije te S. hiq, le të zbret te ura aty le të kshyre”.

Po ashtu se të akuzuarit e tjerë tani më të dënuar e kanë pranuar narkotikun e sjellë nga i akuzuari A.N. dhe me qëllim të transportimit për në Maqedoninë Veriut, e kanë transportuar por nuk kanë pasur sukses për ta dërguar për shkak të kontroleve rrugore të policisë, dëshmojnë edhe provat e administruara në këtë çështje. Me aktgjykimin tani më të formës së prerë për të akuzuarit tani më të dënuar është vërtetuar se këta tani të dënuar kanë pranuar sasinë e narkotikut nga i akuzuari A. (ka papranuar B.S. e nga ai të akuzuarit tjerë) dhe se këtë sasi nuk kanë mundur ta transportojnë për në Maqedoninë Veriut, me datën 08.02.2019, e ku përsëri me datë 09.02.2019, ia kthejnë të dënuarit B.S. e i cili më pas bashkë me të dënuarin G.K. e sistemojnë mobilierinë “N.” pronë e të dënuarit G., e cila sasi e përgjithshme e narkotikut prej 241.33 kg, gjatë kontrollit është sekuestruara nga policia.

Faktet e lartë-theksuara përpos që janë vërtetuar në procesin penal i cili ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë ndaj të dënuarve tjerë në këtë çështje penale, po ashtu gjykata i vë theks të veçantë potencimit se në këtë çështjen penale faktet janë vërtetuar edhe nga provat: BMS e kalimeve të kufirit nga të akuzuarit, si nga kalimet kufitare me Republikën e Shqipërisë e po ashtu edhe me Republikën e Maqedonisë së Veriut (të cilat vërtetojnë kalimin dhe lëvizjet në kufi në ditët kritike të të akuzuarve në këtë çështje penale); përgjimi i telekomunikimeve (të cilat flasin për komunikimet e të akuzuarve në drejtim të transportimit-trafikimit me narkotik nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Kosovës e më pastaj për në Republikën e Maqedonisë së Veriut); raportet e kontrollit dhe gjetjes së narkotikut të braktisur në afërsi të pikës kufitare e po ashtu edhe në mobilierinë e të dënuarit G. (të cilat vërtetojnë gjetjen e narkotikut të cilin e ka transportuar ky grup); dëshmitë e dëshmitarëve; automjetet e sekuestruara e tani të konfiskuara; foto-dokumentacioni në shkresa të lëndës dhe provat tjera të administruara në këtë çështje.

Nga përgjimet e telekomunikimeve e provat tjera të rastit, vërtetohet se narkotiku i pranuar nga A.N. për B.S., është marrë nga tani më të dënuarit tjerë dhe më pas është gjetur e sekuestruar në mobilierinë e të dënuarit G., si:

- Biseda e Xh.S. me B.S. (nofkën H.): “H.” (Xh.) “O shok” (B.), “Hoja” (Xh.), “Çka bone a çka marove” ( B.), “Vallahi qe” (Xh.), “A po bje bore te ju a jo” (B.), “Ja e ka shkri, e kam kalu borën tone” (Xh.), “Po a” (B.), “Aha” (Xh.), “E mire super ... ani ani” (B.), “Për pak për pak”(Xh.);
- Komunikimet e B.S. (me numër telefoni 049...) me G.K. (me numër telefoni 049...), për vendosjen e narkotikut në mobilierinë e G. e ku më pas ky narkotik është sekuestruar në këtë mobilieri;
- Komunikimet e B.S. (me numër telefoni 046...) me J. B. e Z.K. (me numër telefoni 045...), për kthimin e narkotikut dhe vendosjen në mobilierinë “N.” pronë e G.K.;
- Komunikimet e B.S. (me numër telefoni 049...) me djalin e tij të mitur A.S. (me numër telefoni 045...), për vendosjen dhe sistemimin e narkotikut të sjellë nga A.N., në fshatin ... të Komunës së F., fshat i banimit të tani të dënuarit B.S.
- Nga Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes si dhe foto albumi i datës 09.02.2019 dhe i datës 13.02.2019, vërtetohet se në mobilierinë “N.” pronë e të dënuarit G.K., ishte gjetur narkotik i llojit “Marihuanë” nën dy shtretër e në thasë dhe atë sasia e përgjithshme e sekuestruara në këtë mobilieri e potencuar sikurse në këtë aktgjykim;
- Nga BMS e kufijve dhe CD me video-incizime të lëvizjes së të akuzuarit A.N., nga Shqipëria në Kosovë (anasjelltas) dhe lëvizja e të dënuarve tani më në këtë çështje penale, vërtetohet lëvizja e tyre si në zonat kufitare e po ashtu edhe gjatë bartjes së narkotikut (lëvizja dhe vëzhgimi i rrugës) për në fshatin ... të Komunës së F., e nga ky fshat për në drejtim të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pjesën e më sipërme, janë shtjelluar gjetjet e gjykatës sa i përket pretendimeve të të akuzuarit në raport me aktin akuzues dhe provat e administruara në këtë çështje penale, ndërsa në pjesën ku është shtjelluar gjendja faktike, respektivisht veprimet e të akuzuarit dhe përgjegjësia penale në raport me këto veprime, gjykata ka potencuar dhe shtjelluar provat mbi të cilat ka provuar fajësinë e të akuzuarit. Fajësinë e të akuzuarit A.N. i cili ka sjellë narkotikun nga Republika Shqipërisë për në Republikën e Kosovës, tek B.S., e më pas nga të akuzuarit e tjerë tani më të dënuar me vendim të formës së prerë, ky narkotik është tentuar të t4ransportohet në republikën Maqedonisë së Veriut.

*Pretendimet e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij në fjalën përfundimtare dhe gjetjet e gjykatës:*

I akuzuari A.N. dhe mbrojtësi i tij Avokat N. R., si në procesin e parë gjyqësor në këtë çështje penale e po ashtu edhe në këtë të fundit, kanë parashtruar pretendimet e tyre mbrojtëse e duke theksuar se qëndrojnë në pretendimet e parashtruara më herët e po ashtu edhe në ato në procesin e fundit:

- Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se deklarata e dëshmitarit A.S., është provë e pa pranueshme për faktin se kjo deklaratë është dhënë nga dëshmitari i cili ka qenë i liruar nga përgjegjësia për dhënien e dëshmisë, pasi që me të akuzuarin B.S. janë në raport baba-fëmijë,

gjykata, konsideron se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dëshmitar i cili është i liruar nga deklarimi. Dispozita e nenit 127 të KPPRK, nuk përcakton se në çdo rast raporti familjar apo raporti si në rastin konkret baba-fëmijë, është rrethanë për lirimin e dëshmitarit nga përgjegjësia për të dëshmuar, për faktin se kjo dispozitë përcakton se në rastet në të cilat mundë të shqiptohet dënimi të paktën 10 vjet burgim e mbi, nuk janë të liruar. Pra në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale për të cilën mundë të shqiptohet dënimi me 10 vite e më shumë burgim dhe se dëshmitari A.S., nuk ka qenë në kategorinë e dëshmitarëve të liruar nga dëshmia, për këtë arsye gjykata konsideron se deklaratat e këtij dëshmitari të dhëna në këtë çështje penale janë prova të pranueshme;

- Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se deklaratat e dëshmitarit A.S., janë të papranueshme për faktin se ndaj tij është përdorur dhunë gjatë intervistimit, gjykata konsideron se në rastin konkret nuk ka vërtetuar se ndaj këtij dëshmitari është përdorur dhunë. Në raport me këtë fakt, gjykata edhe dëshmitarit B. S. (xhaxhait të A.S.), nuk ia ka falur besimin, pasi që në rastin konkret nuk është vërtetuar që të jetë përdorur dhunë e as që punëtori social nuk ka qenë në kryerje të detyrës së tij gjatë marrjes në pyetje të këtij dëshmitari, respektivisht gjatë intervistimit të A.S. Deklarata e dëshmitarit A.S., është marrë nën monitorimin e punëtorit social, për faktin se babai i tij ka qenë i arrestuar në këtë çështje penale dhe se prezenca e nënës së tij nuk ka mundur të sigurohet pasi që ajo nuk jeton së bashku me të për shkak të disa rrethanave familjare, andaj edhe është siguruar punëtori social i cili gjatë gjithë kohës është kujdesur për të drejtat e këtij dëshmitari. Po ashtu, gjykata, nuk ka vërtetuar se gjatë identifikimit të personave të jetë përdorur forcë apo ndonjë veprim kundërligjor nga hetuesia ndaj dëshmitarit A.S.. Identifikimi është bërë në harmoni me ligjin, me foto-album e po ashtu duke fotografuar edhe dëshmitarin gjatë identifikimit të personave, ku dëshmitari shihet duke bërë me gisht gjatë identifikimit, duke identifikuar vullnetshëm personat e dyshuar;
- Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se ndaj të akuzuarit A.N., është ngritur akti akuzues pa aktvendim për fillim të hetimit dhe se është futur në këtë grup pa asnjë bazë ligjore. Gjykata, nga provat e administruara ka vërtetuar se kjo çështje penale ka qenë një çështje edhe me çështjen penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari A.N., ku më vonë është ndarë kjo çështje penale nga çështja paraprake për të cilën është shpallur fajtor A.N.. Në këtë çështje është sjellë edhe aktvendim për zgjerimin e hetimeve ndaj A.N., pasi që ky i akuzuar ka pasur ndërlidhje edhe me një grup tjetër të akuzuarish për të cilët vetëm se është shpallur fajtor me aktgjykim të formës së prerë. Organi akuzës duke ardhur në përfundim se i akuzuari ka ndërlidhje edhe me këtë vepër penale dhe me këtë grup të kësaj çështjeje penale, ka veçuar dhe zgjeruar procedurën hetimore, me qëllimin që të parashtrahet akti akuzues për ata të akuzuar të cilët i ndërlidhin veprimet inkriminues në veprat penale, pra aktin akuzues për veprimet e grupit të caktuar;

Gjykata, këto pretendime të mbrojtjes së të akuzuarit i ka shqyrtuar në fazën e shqyrtimit të aktit akuzues e po ashtu edhe në shqyrtim gjyqësor, por as në fazën e shqyrtimit të aktit akuzues e as në shqyrtim gjyqësor nuk ka gjetur ndonjë të metë ligjore e cila do ta bënte provën e papranueshme, apo aktin akuzues të pa bazuar apo në kundërshtim me ligjin.

Po ashtu është e rëndësisë së jashtëzakonshme për ta potencuar se Aktgjykimi PS.nr.39/2019 i datës 26.02.2021 (përpos A.N., pjesë e të cilit aktgjykim kanë qenë edhe të akuzuarit tjerë tani më të dënuar me vendim të formës së prerë), është vërtetuar në tërësi për të gjithë të akuzuarit e tjerë dhe atë si me mjete të rregullta juridike e po ashtu edhe me mjete të jashtëzakonshme. Ky aktgjykim në të cilin edhe i akuzuari A.N. ka qenë pjesë e tij, është lënë në fuqi dhe se asnjë nga provat e atakuar nga mbrojtja nuk janë konsideruar të kundërligjshme por në të kundërtën me këto prova të akuzuarit e tjerë tani më të dënuar, janë shpallur fajtor mbi bazën e tyre.

#### Vendimi mbi dënimin:

Gjykata gjatë shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit, mori në konsideratë dhe vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK të cilat rrethana ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata, gjatë vendosjes për dënimin, nuk gjeti ndonjë rrethanë tejet lehtësuese por si rrethana relativisht lehtësuese ndaj të akuzuarit mori: **gjendjen e tij materiale**, ku gjendja e tij materiale është nën mesataren familjare; i akuzuari është mbajtës i vetëm i familjes; dhe **sjellja e tij gjatë gjykimit**, i akuzuari ka pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit, ku sjellja e tij ka qenë korrekte ndaj gjykatës dhe palëve në proces gjyqësor, duke respektuar edhe rendin e procedurën në gjykatore.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, si rrethana tejet rënduese ka konsideruar:

- **Kryerjen e veprës penale si grup**, ku vepra penale nga i akuzuari është kryer si grup me të akuzuarit tjerë (tashmë të dënuar), respektivisht vepra penale e narkotikut, ku i akuzuari ka vepruar si anëtar grupi në kryerjen e kësaj vepre penale e që përbënë edhe me përcaktimin ligjor të veprës penale (kualifikimin juridik të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor) rrethanë tejet rënduese për ashpërsimin e dënimit, pra rrethana për të cilën ligji e ka ashpërsuar edhe dënimin;
- **Sasia e madhe e narkotikut**, në këtë rast të akuzuarit kanë transportuar-trafikuar sasi të madhe të narkotikut, e cila sasi fillimisht është sekuestruar e më pastaj konfiskuar dhe atë sasia e kapur në zonën kufitare në peshë prej 108 kg dhe sasia e kapur në mobilierinë "N." në fshatin S., në peshë prej 241.33 kg;
- **Rrezikshmëria-vlera e mbrojtur shoqërore**, veprat penale të narkotikut, gjithnjë e më shumë po shkojnë drejt trendit të rritjes, ku trendi i rritjes së këtyre veprave penale në shoqëri dhe sasia shumë e madhe e narkotikut të konfiskuar në këtë çështje penale, tregon shkallën e rrezikshmërisë së lartë të kësaj vepre penale (rrezikshmërinë e lartë të veprimeve inkriminuese të këtij të akuzuari), ku kjo rrezikshmëri e lartë kriminale, cenon edhe vlerat më të mbrojtura shoqërore, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, posaçërisht ku përdorues të narkotikut janë grup-moshat e reja si vlerë e rëndësishme e shoqërisë.



Përpos rrethanave tjetër rënduese të cilat janë theksuar sikurse më lartë, gjykata si rrethana rënduese i ka konsideruar:

- **Shkallën e përgjegjësive penale**, ku varësisht pjesëmarrjes dhe rolit të të akuzuarit në kryerjen e veprës penale, gjykata për të akuzuarin A.N. (e disa të akuzuar tjerë tani më të dënuar në procesin paraprak) ka shqiptuar dënim më të ashpër. Këtij të akuzuari i ka shqiptuar dënim më të ashpër sepse i njëjti përveç se ka historik kriminal (është i dënuar për vepra të njëjta penale), ka transportuar-furnizuar narkotikun nga Republika Shqipërisë në Republikën e Kosovës, në raport me të tjerë të akuzuar të kësaj çështjeje të cilët vetëm se janë marrë me vëzhgimin dhe sigurimin e rrugës gjatë transportit të narkotikut me qëllim të kalimit për në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- **Motivi i kryerjes së veprës penale**, motivi i kryerjes së veprës penale ka qenë motivi financiar. I akuzuari për motive të tija financiare, respektivisht për përfitim material, ka anashkaluar të gjitha interesat e përgjithshme shoqërore, ka anashkaluar jetën, sigurinë dhe shëndetin e përgjithshëm të qytetarëve. Kjo nënkupton se i akuzuari në veprimet e tij nuk ka kursyer asgjë në drejtim të kryerjes së veprës penale, respektivisht motivi financiar i tij i kryerjes së veprës penale ka qenë primar në raport me interesin e përgjithshëm, ku pa mëdyshje e ka ditur se veprimet e tij janë të kundërligjshme (përbëjnë vepër penale) dhe se narkotiku paraqet rrezik të përgjithshëm shoqëror, mirëpo motivi i tij i përfitimit material i ka tejkaluar ato.

Andaj, gjykata në bazë të rrethanave të lartë-theksuara, të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse u theksua në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se edhe me këtë dënim të shqiptuar, do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahet nga këto veprime/kryerja e veprës-veprave penale të këtilla.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale:

Vendimi mbi shpenzimet procedurale (paushallin gjyqësor), është marrë në harmoni me nenin 449, 450 dhe 452 të KPPRK, pasi që gjykata në këtë çështje penale ka marrë aktgjykim dënues.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI SPECIAL**  
**PS.nr.38/2022 datë 14 prill 2023**

**Bashkëpunëtoreshë Profesionale,**  
**Ardita Azemi**

**Kryetari Trupit Gjyqësor,**  
**Valon Kurtaj**

Numri i lëndës: 2019:214856  
Datë: 15.06.2023  
Numri i dokumentit: 04396392

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës Apelit-Departamenti Special në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore-Departamenti Special në Prishtinë.

\*\*\*